



Për: Mediat e shkruara dhe elektronike
Nga: Departamenti për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim
Subjekti: Urim

Prishtinë, 07 Mars 2008

Urim

Me 7 mars, gjithë shoqëria kosovare ndihet krenare dhe me falënderim shënon ditën e festës së Mësuesit. Vendi i ynë ka bërë hapa të mëdhenj drejt lirisë dhe demokracisë, norma këto më fisnike të trungut dhe qenies sonë Kombëtar. Sigurisht që mendjet e ndritura të këtij dheu, që janë mësuesit, janë pikërisht ata që na rriten, na zhvilluan, dhe bënë që ta përshpejtojmë rrugën tonë drejt ndërtimit të shtetit të Pavarur. Sakrificat e mësimeve, këtu e dekada me radhë, do të jenë shembull i stoicizmit dhe i besimit në fitore dhe demokraci. AKR-ja me këtë rast u shpreh admirimin më të thellë, respektin më të madhe dhe urimet më të përzemërta të gjithë mësimeve.

AKR-ja është krenare se mendjet e ndritura, pra mësuesit shqiptar, janë pjesë e filozofisë politike dhe nacionale të vendit tonë.

Urime 7 marsi 2008 - dita e mësuesit.

Zyra për Informim
Aleanca Kosova e Re